



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.93/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rufki Suma, kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, të paraqitur kundër, Abdurrahim Bushi, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Hanit të Elezit, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 03.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.93/2025 e datës 02.10.2025 e paraqitur nga Rufki Suma, kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, të paraqitur kundër, Abdurrahim Bushi, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Hanit të Elezit, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 02.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë ZL.Anr.93/2025 të dërguar përmes postës së Kosovës me datë 28.09.2025 nga Rufki Suma, kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit me të cilin pretendon se drejtori i bujqësisë ka shpallur thirrje për aplikim për fermerë me datë 25.09.2025 ku i njëjti drejtor është kandidat për asamble nga rradhët e PDK-së ku shfrytëzon pozitën publike për të përfituar votat e fermerëve që të votojnë për të. Parashtruesi ankesës thekson se ligji per nr 06/L-011 ligji per konflikt interesi, ndalon zyrtaret e lartë publik perfshire drejtortet komunal te marrin vendime te përfitojnë drejte per drejte ose tërthorazi nga fondet, kontratat ose subvencionet e institucionit ku punojnë. Si dëshmi ka bashkangjitur thirrjen per aplikim te datës 25.09.2025.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik PDK kërkon nga PZAP që ankesën e ankuesit t'a refuzoj si të pabazuar për arsye se subjekti politik PDK-ja ka shpërndarë udhëzime të qarta dhe të detajuara për të gjithë anëtarët e saj, duke theksuar rëndësinë e respektimit të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Kjo është një masë për të siguruar që të gjithë të angazhuarit në aktivitete zgjedhore të përmbahen nga përdorimi i gjuhës fyese dhe kërcënuese, si dhe të ruajnë një nivel të lartë etik dhe profesionalizmi gjatë fushatës. Ky veprim i partisë është një dëshmi e angazhimit të saj për të siguruar një proces zgjedhor të ndershëm dhe pa incidente. Shpallja për fermerët nuk përmban asnjë element që e lidh apo e promovon PDK-në. Ajo është një akt i komunës dhe nuk ka asnjë lidhje me fushatën zgjedhore. Ligji nuk parasheh asnjë kufizim për shpalljen e thirrjeve të tilla, edhe gjatë kohës së fushatës, përderisa ato nuk promovohen si aktivitete partiake dhe nuk përmbajnë simbole partiake. Prandaj, bazuar në nenin 118 (vendimet), par. 1 të LZP-së, PZAP-së i propozojmë që të refuzohet ankesa.

Paneli, pasi që shqyrtoj te gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

-Ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Rufki Suma, kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, të paraqitur kundër, Abdurrahim Bushi, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Hanit të Elezit, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimin të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”.*

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave, parashihet që: *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara, ndërsa nën paragrafi 5.5 parasheh që: “për shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”.*

Neni 6, paragrafi 2, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, thekson se *“Ankesa nga personi me interes ligjor parashtrohet me shkrim dhe dorëzohet drejtpërdrejt në PZAP, ose përmes postës e cila duhet të ketë vulën dhe pullën postare të postës së origjinës prej cilit vend është dërguar ankesa”*, ndërsa paragrafi 8 i këtij

neni parasheh që *“Ankesa konsiderohet se është parashtruar në ditën e dorëzimit në PZAP, ose ditën kur është dorëzuar në postë”*.

Pra, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga pala ankuese e njëjta thekson se shkelja ka ndodhur me datën 25.09.2025, ndërsa pala ankuese ankesë e ka dorëzuar në Postën e Kosovës me datën 28.09.2025, pra 24 ore më vonë nga shkelja për të cilën pretendon pala në ankesën e tij, e që nënkupton se ankesa në fjalë është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orësh nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Paneli ka gjetur se ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor, dhe duke u bazuar në nenin 39, paragrafi 3 të LZP-së, dhe nenet 9 paragrafi 5 dhe 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.93/2025 datë 03.10.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi